

Bazuar në Nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Nenin 7 të Rregullores për Procedurat e Rekrutimit si dhe Kapitullin III të Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Kompaninë Rajonale Ujësjetlësi Mitrovica" Sh. A Nr. 2453, Kompania Rajonale Ujësjetlësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, sot me datë 12.06.2026 shpallë këtë:

### KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS:

Punë provuese gjashtë (6) muaj me mundësi vazhdimi

Institucioni:	Kompania Rajonale Ujësjetlësi "Mitrovica" Sh.A.
Pozita e punës:	Shëf/e i/e Kontrollës
Departamenti:	Komercial
Numri i pozitave të hapura:	2
Vendi i Punës:	Mitrovicë (1)/ Vushtrri(1)
Kohëzgjatja e Kontratës:	Me afat të pacaktuar
Periudha Provuese:	Puna provuese 6 (gjashtë) muaj
Orari i Punës:	I plotë
Paga Bazë:	640.17 euro, sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave të KRU "Mitrovica".

Konkursi do të jetë i hapur për pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit, duke filluar nga data 12.06.2026 deri më 26.06.2026 në orën 16:00.

Brenda afatit prej shtatë (7) ditëve, nga data e shpalljes së konkursit, kandidatët e interesuar mund të paraqesin pyetje apo kërkesa për sqarime lidhur me shpalljen e konkursit në formë të shkruar përmes email zyrtar:

[burimet.njerzore3@kru-mitrovica.com](mailto:burimet.njerzore3@kru-mitrovica.com)

## **PËRSHKRIMI I DETYRAVE DHE PËRGJEGJËSIVE TË PUNËS:**

- Mbikëqyr punët e kontrollës, kyçjet legale/ilegale dhe rrjedhjet;
- Siguron dhe raporton zbatimin e procedurave për shkyçje;
- Kontribuon në hartim të planeve të inspektimit dhe kontrollit në terren;
- Mban evidencë dhe harton raporte ditore/javore/mujore;
- Bashkëpunon me Mirëmbajtjen e rrjetit dhe Shefin e Lexuesve;
- Kryen edhe detyra të tjera sipas urdhrit të udhëheqësit;
- Raporton te: Menaxheri i Kontrollës dhe Lidhjeve dhe Menaxherit të Njësisë.

### **I. KUSHTET E PËRGJITHSHME:**

Kandidati/ja duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme si më poshtë:

- Duhet të jetë shtetas/e i/e Republikës së Kosovës;
- Të ketë mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare;
- Të mos jetë dënuar me më shumë se gjashtë (6) muaj burgim me vendim të formës së prerë;
- Të dëshmojë se është i aftë për punë;
- Të ketë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe bashkëpunimi me menaxhmentin e kompanisë;
- Të njohë punën me kompjuter, veçanërisht programet MS Office;
- Njohja e dygjuhësisë (Shqipe-Serbe)do të konsiderohet përparësi.

### **II. KUSHTET E VEÇANTA:**

**Shkollimi: Niveli Bachelor**

**Përvoja e punës: 2 vite.**

### III. DOKUMENTET E KËRKUARA:

Kandidatët e interesuar duhet t'i bashkëngjisnin këto dokumente:

- **Aplikacionin zyrtar të KRU "Mitrovica",** i cili mund të shkarkohet në ueb-faqen zyrtare të kompanisë në adresën: [www.kru-mitrovica.com/konkurset](http://www.kru-mitrovica.com/konkurset);
- **CV-në (biografia);**
- **Kopjen e vlefshme të letërnjoftimit të lëshuar nga Republika e Kosovës;**
- **Dëshmia lidhur me shkollimin (Diploma):**
  - o Sipas kriterëve të përcaktuara, kërkohet kopje e noterizuar e diplomës. Në rast se kandidati nuk e ka paraqitur kopjen e noterizuar gjatë aplikimit, është i obliguar ta dorëzojë para nënshkrimit të kontratës.
  - o Në rastet kur diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës ose dëshminë se diploma e fituar është në procedurë nostrifikimi, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të kontratës.
  - o Për diplomat e lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, duhet të paraqitet vërtetimi për verifikim nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë dhe Invokacionit (MASHTI) ose dëshmia e aplikimit për verifikim, me kusht që verifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të kontratës.
- **Certifikatën nga evidenca penale,** jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj, që dëshmon se kandidati nuk është dënuar me më shumë se gjashtë (6) muaj burgim me vendim të formës së prerë.
- **Certifikatën mjekësore lidhur me aftësinë për punë** – jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj, e cila dorëzohet në rast të punësimit;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës** (trusti pensional, kontratë pune ose vërtetim nga punëdhënësi që dëshmon funksionin apo detyrat e punës dhe kohëzgjatjen e angazhimit).

### IV. MËNYRA E APLIKIMIT:

Aplikacioni, së bashku me dokumentet përcjellëse sipas pikës III, duhet të dorëzohen fizikisht, në selinë e Kompanisë, në sportelin e pranim-dorëzimeve gjatë orarit të rregullt të punës.

**V. DATA E PUBLIKIMIT TË REZULTATEVE TË VLERËSIMIT PARAPRAK**

Vetëm Kandidatët që plotësojnë kushtet për pjesëmarrje testim me shkrim dhe pastaj në intervistë me gojë do të njoftohen individualisht përmes email-it [burimet.njerezore3@kru-mitrovica.com](mailto:burimet.njerezore3@kru-mitrovica.com) në linjë me afatet e përcaktuara në Rregulloren për Procedurat e Rekrutimit.

**VI. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE/APLIKANTËVE:**

Për këtë pozitë, kandidatët vlerësohen në dy (2) faza:

**Faza e parë**

- Testimi me Shkrim - deri në njëqind (100) pikë shumëzuar me peshë gjashtëdhjetë përqind (60%);

**Faza e dytë:**

- Biografia (CV) - deri në njëqind (100) pikë shumëzuar me dhjetë përqind (10%); dhe
- Intervista - deri në njëqind (100) pikë shumëzuar me tridhjetë përqind (30%).

**VII. MËNYRA E NJOFTIMIT DHE KOMUNIKIMIT ME KANDIDATËT**

Të gjitha komunikimet me kandidatët do të bëhen vetëm përmes emailit të rekrutimit elektronik: [burimet.njerezore3@kru-mitrovica.com](mailto:burimet.njerezore3@kru-mitrovica.com)

**VËREJTJE:**

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar nuk do të pranohen.

Aplikacionet e paplotësuara ose aplikacionet që nuk i bashkëngjisin të gjitha dokumentet e kërkuara, do të refuzohen dhe nuk do t'u nënshtrohen procedurës të mëtejme të vlerësimit.

Kandidatët që dështojnë të paraqiten në ndonjërin nga fazat e vlerësimit pa arsye, konsiderohet se kanë hequr dorë nga konkursi.

